

PROPOZIMI

I LIGJIT PËR NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E LIGJIT MBI TË DREJTAT DHE LIRITË E PAKICAVE

Neni 1

Në Ligjin mbi të drejtat dhe liritë e pakicave (“ Gazeta Zyrtare e RMZ ”), nr.31/06, 51/06 dhe 38/07 dhe “ Gazeta Zyrtare e MZ”, nr.2/11 dhe 8/11), në nenin 7, paragrafi 3, pas fjalës “aktivitetet”, në vend të presjes vihet pikë, kurse fjalët : “ si dhe integrimin sa më të madh të romëve në jetën shoqërore dhe politike të Malit të Zi “ hiqen.

Neni 2

Pas nenit 7 shtohet një nen i ri, me këtë përmbajtje :

“ Neni 7a

Shprehjet që në këtë ligj përdoren për personat fizikë në gjininë mashkullore nënkuptojnë të njëjtat shprehje edhe në gjininë femërore “.

Neni 3

Pas nenit 8 shtohet një nen i ri, me këtë përmbajtje :

“ Neni 8a

Me qëllim të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të pakicave, të nxitjes së ruajtjes, zhvillimit dhe shprehjes së kulturës së popujve pakicë dhe të bashkësive të tjera nacionale të pakicave në Mal të Zi dhe të nxitjes së frymës së tolerancës dhe të dialogut ndërkulturor dhe të respektimit dhe mirëbesimit reciprok, Qeveria themelon institucionin publik, sipas mënyrës dhe kushteve të përcaktuara me ligjin me të cilin rregullohet veprimtaria e institucioneve të kulturës.

Mbikqyrjen e punës së institucionit nga paragrafi 1 i këtij neni e ushtron organi i administratës shtetërore me kompetencë për të drejtat e njeriut dhe të pakicave”.

Neni 4

Në nenin 11, paragrafi 2, fjalët : ” një pjesë të rëndësishme “ zëvendësohen me fjalët : “ të paktën 5 % “, kurse fjalët : “ nga regjistrimi i fundit “ zëvendësohen me fjalët : “ nga 2 regjistrimet e njëpasnjëshme të fundit “

Neni 5

Në nenin 19, fjalët : “ Universiteti i Malit të Zi “ zëvendësohen me fjalët : “ institucionet universitare në Mal të Zi “, kurse fjalët : “ me aktin e Universitetit “ zëvendësohen me fjalët : “ me aktin e institucionit universitar në Mal të Zi. “.

Neni 6

Në nenin 28, pas paragrafit 1 shtohet një paragraf i ri, me këtë përmbajtje :

“ Në njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilat popujt pakicë dhe bashkësitë e tjera nacionale të pakicave përbëjnë shumicën apo të paktën 5 % të popullsisë, Qeveria e Malit të Zi është e detyruar që popullatën lokale, përmes këshillave të popujve pakicë dhe të bashkësive të tjera nacionale të pakicave t’i kyçë në përgatitjen, zbatimin dhe vlerësimin e planeve dhe programeve nacionale dhe rajonale të zhvillimit, të cilat mund të kenë ndikim të drejtëpërdrejtë mbi ta, si dhe hartimin e studimeve me qëllim të vlerësimit të ndikimit të mundshëm të aktiviteteve të projektuara zhvillimore mbi popullsinë lokale për krijimin e një ambienti më të mirë për veprimtari sipërmarrëse, për zhvillim ekonomik dhe për një jetë më të mirë. “

Neni 7

Pas nenit 32 shtohet një nen i ri, me këtë përmbajtje :

“ Neni 32a

Me qëllim të ruajtjes, avancimit dhe mbrojtjes së veçantive nacionale, etnike, fetare, gjuhësore dhe kulturore të pjesëtarëve të popujve pakicë dhe të bashkësive të tjera nacionale të pakicave dhe me qëllim të realizimit të të drejtave të tyre, Qeveria e Malit të Zi themelon Këshillin e popujve pakicë dhe të bashkësive të tjera nacionale të pakicave.

Qeveria e Malit të Zi përcakton përbërjen dhe kompetencën e Këshillit të popujve pakicë dhe të bashkësive të tjera nacionale të pakicave.

Përfundimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, në përbërje të Këshillit të popujve pakicë dhe të bashkësive të tjera nacionale të pakicave mund të hyjnë edhe përfaqësuesit e këshillave të popujve pakicë dhe të bashkësive të tjera nacionale të pakicave “.

Neni 8

Në nenin 33, në paragrafin 9, pas fjalës “ neni “, vihet pikë, kurse fjalët :

“ dhe anëtarët e organeve të partive politike. “ hiqen.

Në paragrafin 10, fjalët : “ Organi i administratës shtetërore me kompetencë për të drejtat e pakicave “, zëvendësohen me fjalët : “ Organi i administratës shtetërore me kompetencë për të drejtat e njeriut dhe të pakicave “.

Në paragrafin 13, pas fjalës “ statuti “, vihet presja dhe shtohen fjalët : “ plani vjetor i punës “.

Në paragrafin 14, pas fjalës “ sigurohen “ shtohen fjalët : “ në shumën prej të paktën 0.10 % të mjeteve të përgjithshme buxhetore, të pakësuara për buxhetin e fondeve shtetërore dhe buxhetin kapital.”.

Neni 9

Në nenin 35, paragrafi 1, alinea 6, fjalët : “ Universiteti i Malit të Zi “ zëvendësohen me fjalët : “ institucionet universitare në Mal të Zi ;”.

Neni 10

Pas nenit 35 shtohet një nen i ri me këtë përmbajtje :

“ Neni 35 a

Mandati i anëtarit të këshillit pushon :

- me pushimin e funksionit në bazë të të cilit është bërë anëtar i këshillit ;
- në qoftë se i kryen në mënyrë të pandërgjegjshme punët e anëtarit të këshillit ;
- në qoftë se përgjithmonë e humbet aftësinë për t'i kryer punët e anëtarit të këshillit ;
- në qoftë se është gjykuar me dënim me burgim pa kusht ose është dënuar për vepër penale e cila e bën të padenjë për të kryer punët e anëtarit të këshillit ;
- në qoftë se anëtari i këshillit nuk e justifikon mosardhjen e vet në seancën e këshillit të pakten tri herë gjatë vitit kalendarik ; dhe
- me kërkesë personale. “

Neni 11

Pas nenit 35a shtohet një kapitull i ri, me këtë përmbajtje :

“ IIa FONDI PËR MBROJTJEN DHE REALIZIMIN E TË DREJTAVE TË PAKICAVE “

Neni 12

Në nenin 36, paragrafët 2 dhe 3 ndryshohen dhe kanë këtë përmbajtje :

“ Fondi ka cilësinë e personit juridik.

Me aktin mbi themelimin e Fondit rregullohen hollësisht kompetencat dhe mënyra e vendosjes së organeve të Fondit, si dhe çështjet e tjera të përcaktuara me këtë ligj”.

Neni 13

Neni 36a ndryshohet dhe ka këtë përmbajtje :

“ Organet e Fondit janë këshilli drejtues dhe drejtori “.

Neni 14

Pas nenit 36a shtohen 20 nene të reja, me këtë përmbajtje :

“ Neni 36b

Këshilli drejtues është organ qeverisës i Fondit.

Këshilli drejtues i Fondit përbëhet nga :

- tre përfaqësues të Kuvëndit të Malit të Zi, nga të cilët të paktën njëri është përfaqësues i partisë politike të popujve pakicë dhe bashkësive të tjera nacionale të pakicave ;
- një përfaqësues i Ministrisë ;
- një përfaqësues i institucionit universitar ;
- një përfaqësues i secilit nga këshillat e popujve pakicë ose të bashkësive të tjera nacionale të pakicave :
- një ekspert i pavarur i cili merret me të drejtat e njeriut dhe të pakicave ; dhe
- një përfaqësues i organit të administratës shtetërore me kompetencë për media.

Anëtarët e këshillit drejtues të Fondit zgjedhen me mandat prej katër vitesh dhe i njëjti person mund të zgjedhet anëtarë i këshillit drejtues jo më shumë se dy herë rresht.

Kuvendi i Malit të Zi zgjedh dhe shkarkon anëtarët e këshillit drejtues të Fondit.

Neni 36c

Anëtar i këshillit drejtues të Fondit mund të zgjedhet personi që ka tri vite përvojë pune nga lëmi i të drejtave dhe lirive të pakicave dhe ka përvojë në përgatitjen, realizimin ose evaluimin e projekteve nga fusha e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Neni 36ç

Anëtarët e këshillit drejtues të Fondit propozohen nga :

- forumi i punës i Kuvendit të Malit të Zi me kompetencë për të drejtat e njeriut dhe të pakicave – anëtarët e këshillit drejtues nga neni 36b, paragrafi 2, alinetë 1, 3 dhe 5, të këtij ligji ;

- Ministria – anëtarin e këshillit drejtues nga neni 36b, paragrafi 2, alinea 2 të këtij ligji;

- këshillat e popujve pakicë ose të bashkësive të tjera nacionale të pakicave – anëtarin e këshillit drejtues nga neni 36b, paragrafi 2, alinea 4, të këtij ligji ;

- organi i administratës shtetërore me kompetencë për media – anëtarin e këshillit drejtues nga neni 36b, paragrafi 2, alinea 6, të këtij ligji.

Anëtari i këshillit drejtues nga neni 36b, paragrafi 2, alinetë 3 dhe 5 të këtij ligji zgjedhet në bazë të thirrjes publike, të cilën e zbaton propozuesi nga paragrafi 1, alinea 1 e këtij neni.

Përmbajtja dhe mënyra e shpalljes së thirrjes publike nga paragrafi 2 i këtij neni, si dhe mënyra e zbatimit të procedurës së përcaktimit të propozimit të kandidatëve përcaktohen me aktin nga neni 36, paragrafi 3, i këtij ligji.

Neni 36d

Këshilli drejtues i Fondit :

- nxjerr statutin e Fondit ;

- miraton programet dhe planet e punës të Fondit ;
- zgjedh drejtorin e Fondit ;
- miraton raportin mbi veprimtarinë financiare dhe llogarinë përfundimtare të Fondit ;
- miraton raportin vjetor për punën e Fondit ;
- merr vendim për shpalljen e konkursit publik për shpërndarjen e mjeteve për financimin e projekteve për mbështetjen e aktiviteteve nga neni 36, paragrafi 1 i këtij ligji ;
- vepron si organ i shkallës së dytë lidhur me ankesat ndaj vendimeve të drejtorit të Fondit ;
- nxjerr aktin mbi organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të Fondit ;
- nxjerr rregulloren e punës ;
- vendos lidhur me çështjet e tjera, në përputhje me ligj dhe me aktin mbi themelimin e Fondit.

Këshilli drejtues mund të vendosë kur në seancën e këtij këshilli të jenë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.

Këshilli drejtues merr vendim me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve.

Neni 36dh

Anëtari i këshillit drejtues të Fondit mund të shkarkohet para skadimit të mandatit :

- në qoftë se humbet përgjithmonë aftësinë punuese për ushtrimin e funksionit të anëtarit të këshillit drejtues ;
- në qoftë se është gjykuar me dënimin me burg pa kusht ose është dënuar për vepër penale apo për ndonjë vepër tjetër që e bën të padenjë për ta ushtruar funksionin ; dhe
- me kërkesë personale.

Në rastin kur anëtarit të këshillit drejtues të Fondit i pushon anëtarësia në këshillin drejtues me anë të shkarkimit, propozuesit nga neni 36ç, paragrafi 1 i këtij ligji, përfaqësuesi i të cilëve është shkarkuar, do të propozojnë një përfaqësues të ri për anëtar të këshillit drejtues, sipas mënyrës së përcaktuar me këtë ligj.

Mënyra e konstatimit të shkaqeve për shkarkimin e anëtarit të këshillit drejtues të Fondit dhe e njoftimit të Kuvendit të Malit të Zi mbi këto shkaqe, përcaktohen me aktin nga neni 36, paragrafi 3 i këtij ligji.

Neni 36e

Drejtori i Fondit zgjedhet nga këshilli drejtues i Fondit në bazë të konkursit publik.

Drejtori i Fondit zgjedhet me mandat prej katër vitesh dhe i njëjti person mund të zgjedhet drejtor i Fondit jo më shumë se dy herë rresht.

Drejtor i Fondit mund të zgjedhet personi i cili ka nivelin VII1 të kualifikimit universitar dhe tri vite përvojë pune nga lëmi i të drejtave dhe lirive të pakicave apo përvojë në përgatitjen, realizimin ose evaluimin e projekteve nga lëmi i të drejtave dhe lirive të pakicave.

Neni 36ë

Drejtori i Fondit :

- përfaqëson dhe prezanton Fondin dhe organizon punën dhe veprimtarinë e Fondit ;
- zbaton vendimet e këshillit drejtues të Fondit ;
- propozon statutin e Fondit, programin dhe planin e punës së Fondit, aktin mbi organizimin dhe sistematizimin e brendshëm dhe aktet e tjera të Fondit ;
- i paraqet këshillit drejtues të Fondit raportin mbi veprimtarinë financiare dhe llogarinë përfundimtare të Fondit ;
- është përgjegjës për veprimtarinë dhe ligjshmërinë e punës së Fondit ;
- merr vendim për ndarjen e mjeteve për finansimin e projekteve për mbështetjen e aktiviteteve nga neni 36, paragrafi 1 i këtij ligji ;
- të punësuarve në shërbim të Fondit u siguron trajnime të rregullta profesionale për monitoringun dhe evaluimin e projekteve, në kohëzgjatje prej të paktën pesë ditëve në vit ;
- zbaton monitoringun dhe evaluimin e projekteve të sponsorizuara për mbështetjen e aktiviteteve nga neni 36, paragrafi 1 i këtij ligji ;

- i paraqet këshillit drejtues të Fondit raportin vjetor për punën e Fondit, monitoringun dhe evaluimin e projekteve të sponsorizuara për mbështetjen e aktiviteteve nga neni 36, paragrafi 1 i këtij ligji ;

- bën hulumtimin e opinionit publik mbi punën e Fondit dhe aktivitetet e nevojshme, të rëndësishme për ruajtjen dhe zhvillimin e veçantive nacionale, respektivisht etnike të popujve pakicë dhe të bashkësive të tjera nacionale minoritare dhe të pjesëtarëve të tyre ; dhe

- kryen punë të tjera të përcaktuara me statut dhe me aktin mbi themelimin e Fondit.

Neni 36f

Anëtarët e këshillit drejtues dhe drejtori i Fondit nuk mund të jenë të angazhuar në realizimin e projekteve për mbështetjen e aktiviteteve nga neni 36, paragrafi 1 i këtij ligji, të financuara nga mjetet e Fondit.

Neni 36g

Me statutin e Fondit rregullohet më hollësisht organizimi dhe mënyra e punës së Fondit.

Kuvendi i Malit të Zi jep pëlqimin ndaj statutit të Fondit.

Neni 36gj

Fondi financohet nga buxheti i Malit të Zi dhe nga burime të tjera, në përputhje me ligjin.

Me buxhetin e Malit të Zi për destinimet nga paragrafi 1 i këtij neni do të veçohen të paktën 0.15 % të mjeteve të përgjithshme buxhetore, të pakësuara për buxhetin e fondeve shtetërore dhe për buxhetin kapital.

Neni 36h

Fondi shpall konkurs publik për shpërndarjen e mjeteve për financimin e projekteve për mbështetjen e aktiviteteve nga neni 36, paragrafi 1 i këtij neni.

Konkursi publik nga paragrafi 1 i këtij neni publikohet në faqen e internetit të Fondit dhe të paktën në një medie të shtypur me seli në Mal të Zi.

Pjesëmarrësit e konkursit publik, projektet për mbështetjen e aktiviteteve nga neni 36, paragrafi 1 i këtij ligji, mund t'ia dorëzojnë fondit drejtëpërsëdrejti ose me anë të postës.

Brenda tetë ditëve nga data e skadimit të afatit për dorëzimin e projekteve nga paragrafi 1 i këtij neni në konkurs publik, Fondi ia dorëzon projektet komisionit nga neni 36j i këtij ligji.

Neni 36i

Mjetet nga neni 36gj i këtij ligji sistemohen në :

- mjetet për punën e Fondit ; dhe
- mjetet për financimin e projekteve për mbështetjen e aktiviteteve nga neni 36, paragrafi 1 i këtij ligji.

Këshilli drejtues i Fondit, në bazë të programeve dhe planeve të punës të fondit, pas marrjes paraprake të mendimit të këshillave të popujve pakicë apo të bashkësive të tjera nacionale të pakicave, merr vendim mbi pjesëmarrjen proporcionale të mjeteve për punën e Fondit dhe të mjeteve për financimin e projekteve për mbështetjen e aktiviteteve nga neni 36, paragrafi 1, i këtij ligji.

Mjetet nga paragrafi 1, alinea 2 e këtij neni, shpërndahen në bazë të konkursit publik nga neni 36h i këtij ligji, sipas kriterëve vijuese :

- ruajtja dhe zhvillimi i identitetit nacional, fetar dhe etnik të çdo populli pakicë apo të çdo bashkësie nacionale të pakicës ;
- kompatibiliteti i projektit me dokumentet strategjike të Qeverisë ;
- kontributi që i jep projekti bashkëpunimit ndërkulturor dhe zvogëlimit të distancës etnike ;
- promovimi i frymës së tolerancës, dialogut ndërkulturor dhe respektimit dhe mirëkuptimit reciprok ;
- transparenca dhe mundësia e kontrollit të realizimit të projektit ; dhe
- kapacitetet profesionale dhe teknike të paraqitësit të projektit.

Të drejtë pjesëmarrjeje në konkurs publik për ndarjen e mjeteve nga paragrafi 1, alinea 2 e këtij neni, kanë organizatat joqeveritare dhe personat e tjerë juridikë dhe fizikë, veprimtaritë, respektivisht aktivitetet e të cilëve janë të orientuara në ruajtjen dhe zhvillimin e të drejtave të pakicave, të veçantive nacionale, respektivisht etnike të

popujve pakicë apo të bashkësive të tjera nacionale të pakicave dhe të pjesëtarëve të tyre në sferën e identitetit nacional, etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar.

Në konkursin publik për ndarjen e mjeteve nga paragrafi 1, alinea 2 e këtij neni, nuk mund të marrin pjesë organizatat joqeveritare dhe personat e tjerë juridikë dhe fizikë të cilëve brenda të njëjtit vit kalendarik me vendimin e Fondit u janë financuar dy projekte ose një projekt në shumën 5 % të totalit të mjeteve të veçuara për financimin e projekteve për mbështjetjen e aktiviteteve nga neni 36, paragrafi 1 i këtij ligji.

Organizatat joqeveritare dhe personat e tjerë juridikë dhe fizikë nga paragrafi 4 i këtij neni, i paraqesin projektet në konkurs publik nga neni 36h i këtij ligji, në formularin e parashikuar, si dhe dokumentacionin e nevojshëm me të cilin dëshmojnë përmbushjen e kriterëve nga paragrafi 3 i këtij neni dhe kushtet e përcaktuara për pjesëmarrje në konkurs.

Vlerësimi i projekteve sipas kriterëve nga paragrafi 3 i këtij neni bëhet në formularin e parashikuar.

Ministria përcakton mënyrën e vlerësimit të projekteve sipas kriterëve nga paragrafi 3 i këtij neni, si dhe formën dhe përmbajtjen e formularëve dhe dokumentacionin e nevojshëm nga paragrafët 6 dhe 7 të këtij neni.

Neni 36j

Me qëllim të vlerësimit të projekteve të arritura në konkurs publik për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve për mbështjetjen e aktiviteteve nga neni 36, paragrafi 1 i këtij ligji, në bazë të kriterëve nga neni 36i, paragrafi 3 i këtij ligji, Kuvendi i Malit të Zi zgjedh komisionin (në tekstin e mëtejme : komisioni i vlerësimit).

Komisioni i vlerësimit ka shtatë anëtarë.

Anëtarët e komisionit të vlerësimit zgjedhen në bazë të thirrjes publike, me mandat prej katër vitesh, dhe i njëjti person mund të zgjedhet anëtar i komisionit jo më shumë se dy herë rresht.

Fondi kryen punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit të vlerësimit.

Neni 36k

Anëtar i komisionit mund të zgjedhet personi që ka shkallën VIII të kualifikimit universitar dhe të paktën tre vite përvojë pune në lëmin e të drejtave dhe lirive të

pakicave, si dhe pervojë në përgatitjen, realizimin ose evaluimin e projekteve nga sfera e të drejtave dhe lirive të pakicave.

Personi i cili dëshiron të jetë zgjedhur anëtar i komisionit të vlerësimit është i detyruar që të deklarohet në formë shkresore se nuk është në konflikt interesi.

Anëtari i komisionit të vlerësimit mund të shkarkohet para skadimit të mandatit :

- në qoftë se humbet përgjithmonë aftësinë punuese për ushtrimin e funksionit të anëtarit të komisionit të vlerësimit ;

- në qoftë se është gjykuar me dënimin me burgim pa kusht apo është gjykuar për vepër penale apo për ndonjë vepër tjetër e cila e bën të padenjë për ushtrimin e funksionit të anëtarit të komisionit të vlerësimit ; dhe

- me kërkesë personale.

Anëtari i komisionit të vlerësimit nuk mund të aplikojë dhe as të angazhohet në realizimin e projekteve të sponsorizuara për mbështetjen e aktiviteteve nga neni 36, paragrafi 1 i këtij ligji.

Neni 36l

Thirrjen publike nga neni 36, paragrafi 3 i këtij ligji e shpall Kuvendi i Malit të Zi në faqen e vet të internetit dhe në të paktën një medie të shtypur me seli në Mal të Zi.

Thirrja publike nga neni 36j, paragrafi 3 i këtij ligji përmban numrin e përfaqësuesve në komisionin e vlerësimit, kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët në përputhje me nenin 36k të këtij ligji dhe provat për plotësimin e kushteve, si dhe afatin dhe mënyrën e dërgimit të fletëparaqitjeve.

Fletëparaqitjet e veta, në bazë të thirrjes publike nga paragrafi 1, i këtij neni, kandidatët ia dërgojnë Kuvendit të Malit të Zi drejtëpërsëdrejti ose me anë të postës, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e shpalljes së thirrjes publike.

Propozimin për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit të vlerësimit e percakton forumi i punës i Kuvendit të Malit të Zi, me kompetencë për të drejtat e njeriut dhe të pakicave.

Neni 36ll

Komisioni i vlerësimit :

- konstaton plotësimin e kushteve nga neni 36i, paragrafët 3 dhe 4 të këtij ligji ;
- bën vlerësimin e projekteve në përputhje me kriteret nga neni 36i, paragrafi 3 i këtij ligji ;
- përcakton rang – listën e projekteve të vlerësuara ; dhe
- përcakton propozimin e shumës së mjeteve për financimin e projekteve për mbështetjen e aktiviteteve nga neni 36, paragrafi 1 i këtij ligji.

Neni 36m

Anëtari i komisionit të vlerësimit nuk mund të angazhohet në realizimin e projekteve të sponsorizuara për mbështetjen e aktiviteteve nga neni 36, paragrafi 1, i këtij ligji.

Neni 36n

Në bazë të propozimit nga neni 36ll, paragrafi 1, alinea 4 e këtij ligji, drejtori i Fondit merr vendimin për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve për mbështetjen e aktiviteteve nga neni 36, paragrafi 1 i këtij ligji.

Drejtori i Fondit mund të vendosë që të mos e pranojë propozimin nga neni 36ll, paragrafi 1, alinea 4 e këtij ligji, po qe se konsideron se nuk janë plotësuar kushtet nga neni 36i, paragrafët 4 dhe 5 të këtij ligji, ose vlerësimi i projekteve nuk është bërë në përputhje me kriteret nga neni 36i, paragrafi 3 i këtij ligji.

Vendimin e arsyetuar për mospranimin e propozimit nga paragrafi 2 i këtij neni drejtori i Fondit ia kthen komisionit të vlerësimit brenda 8 ditëve nga data e mosprimit të tij.

Komisioni i vlerësimit është i detyruar që vendimin për mospranimin e propozimit nga paragrafi 3 i këtij neni ta shqyrtojë përsëri dhe ta rishqyrtojë propozimin e vet brenda 8 ditëve nga data e marrjes së tij, duke marrë parasysh shkaqet të cilat drejtori i ka theksuar në vendimin nga paragrafi 2 i këtij neni dhe pastaj drejtorit të Fondit t'ia dërgojë propozimin e ri të vendimit për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve për mbështetjen e aktiviteteve nga neni 36, paragrafi 1 i këtij ligji.

Pas marrjes së propozimit të vendimit nga paragrafi 4 i këtij neni, drejtori i Fondit ka për detyrë që të marrë vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve për mbështetjen e aktiviteteve nga neni 36, paragrafi 1 i këtij ligji.

Përkitazi me vendimet nga paragrafët 1 dhe 5 të këtij neni, pjesëmarrësit në konkurs mund t'i paraqesin ankesë këshillit drejtues të Fondit brenda 8 ditëve nga dita e marrjes së vendimit.

Vendimin rreth ankesës këshilli drejtues i Fondit është i detyruar për ta marrë brenda 15 ditëve nga skadimi i afatit për parashtrimin e ankesës.

Vendimet nga paragrafët 1 dhe 5 të këtij neni publikohen në faqen e internetit të Fondit dhe të paktën në një medie të shkruar me seli në Mal të Zi, brenda afatit prej 3 ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar.

Ndarja e mjeteve për financimin e projekteve për mbështetjen e aktiviteteve nga neni 36, paragrafi 1 i këtij ligji bëhet pas vendimit përfundimtar.

Neni 36nj

Punët profesionale dhe administrative për nevoja të Fondit i kryen shërbimi profesional i Fondit.

Ndaj të punësuarve në shërbimin profesional të Fondit zbatohen dispozitat mbi nëpunësit e shtetit dhe zëvendësit e tyre.

Neni 36 o

Krahas kontrollit të prashikuar me ligj të shpenzimit të mjeteve buxhetore, Fondi përmes nëpunësit të autorizuar në shërbimin profesional siguron kontrollin intern dhe revizionin e projekteve vijuese dhe projekteve të përfunduara në lidhje me shfrytëzimin me destinim dhe me shfrytëzimin ligjor të mjeteve në përputhje me ligjin me të cilin rregullohet sfera e financave.

Neni 36p

Fondi i paraqet raportin vjetor për punën e vet Kuvendit të Malit të Zi, jo më vonë se deri më 31 mars të vitit vijues për vitin paraprak.

Kuvendi i Malit të Zi mund të kërkojë raport të veçantë lidhur me çështjet nga fushëveprimi i punës së Fondit, në qoftë se është fjala për çështjet me rëndësi për realizimin e të drejtave dhe lirive të pakicave apo për zbatimin e politikës së të drejtave të pakicave në Mal të Zi “.

Neni 15

Pas nenit 42b shtohen 2 nene të reja me këtë përmbajtje :

“ Neni 42c

Akti nënligjor nga neni 36i, paragrafi 8 i këtij ligji, do të miratohet brenda 90 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 42 ç

Vendimi mbi themelimin e Qendrës për ruajtjen dhe zhvillimin e kulturës së pakicave (“ Gazeta Zyrtare e RMZ “, nr.38/01dhe 27/07 dhe “ Gazeta Zyrtare e MZ “, numër 3/10) do të harmonizohen me këtë ligj, brenda 90 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

Neni 16

Pas nenit 44 shtohen pesë nene të reja, me këtë përmbajtje :

“ Neni 44a

Vendimi mbi themelimin e Fondit për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të pakicave (“ Gazeta Zyrtare e MZ “, nr.13/08 dhe 64/11), do të harmonizohen me këtë ligj brenda 90 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 44b

Zgjedhja e këshillit drejtues të Fondit, në përputhje me këtë ligj do të kryhet brenda 90 ditëve nga dita e harmonizimit të aktit nga neni 44a i këtij ligji.

Neni 44c

Zgjedhja e drejtorit të Fondit do të bëhet brenda 90 ditëve nga data e zgjedhjes së këshillit drejtues të Fondit.

Neni 44ç

Këshilli drejtues dhe drejtori i Fondit, të zgjedhur para hyrjes së këtij ligji në fuqi, vazhdojnë punën deri me zgjedhjen e këshillit drejtues dhe drejtorit të Fondit në përputhje me këtë ligj.

Neni 44d

Anëtarët e komisionit të vlerësimit do të zgjedhen brenda 90 ditëve nga zgjedhja e këshillit drejtues të Fondit “.

Neni 17

Ky ligj hyn në fuqi ditën e 8 nga data e botimit në “Gazetën Zyrtare të Malit të Zi“.

ARSYETIM

I BAZA KUSHTETUESE PËR NXJERRJEN E LIGJIT

Baza kushtetuese për nxjerrjen e këtij ligji përmbahet në nenin 16, paragrafi 1, pika 2 të Kushtetutës së Malit të Zi, me të cilin përcaktohet që, në përputhje me Kushtetutën, me ligj rregullohet mënyra e realizimit të të drejtave të veçanta të pakicave.

II ARSYET PËR NXJERRJEN E LIGJIT

Ligji për të drejtat dhe liritë e pakicave u miratua në vitin 2006, me qëllim që të rregullohet lëmi i të drejtave dhe lirive të veçanta të pakicave. Ndërkohë, rrethanat qenësore të kushtëzuara nga ndryshimet shoqërore dhe nga ndryshimi i statusit juridiko – shtetëror të Malit të Zi, kushtëzuan nxjerrjen e një akti të ri kushtetues dhe përcaktimin taksativ të lirive dhe të drejtave të veçanta të popujve pakicë, të bashkësive të tjera nacionale të pakicave dhe të pjesëtarëve të tyre (nenet 79 dhe 80 të Kushtetutës së Malit të Zi).

Para hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Malit të Zi, me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Malit të Zi U.nr.53/06 të datës 11 korrik 2006, janë shfuqizuar dispozitat e neneve 23 dhe 24 të këtij Ligji, me arsyetimin se me këto dispozita minohet parimi i barazisë në realizimin e të drejtave dhe lirive të pakicave, pastaj parimi i barazisë në realizimin e të drejtës së votimit, si njëri nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Me ndryshimet e fundit të legjislacionit zgjedhor, kjo sferë është rregulluar me ligj të veçantë, ashtu siç janë rregulluar me ligje të posaçme edhe disa sfera të tjera.

Ligji aktual mbi të drejtat dhe liritë e pakicave në aspektin e klerarkisë ka të njëjtën fuqi juridike sikurse aktet e tjera ligjvënëse (nuk është ligj me fuqi juridike më të madhe), kështu që nuk mund të derogojë dispozitat e ligjeve të veçanta me të cilat rregullohen të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve të Malit të Zi, përfshirë edhe ato të drejta që u takojnë popujve pakicë dhe bashkësive të tjera nacionale të pakicave.

Nga një kufizim i këtillë normativ, arsyet themelore për nxjerrjen e këtij ligji janë të përqendruara drejt ndërhyrjes në pjesën e mbështetjes institucionale realizimit të të drejtave dhe lirive të pakicave, transparencës dhe efektivitetit të procedurave me të cilat bëhet ndarja e mjeteve për realizimin e projekteve të destinuara për aktivitetet e rëndësishme për ruajtjen dhe zhvillimin e veçantive nacionale, përkatësisht etnike të popujve pakicë dhe të bashkësive të tjera nacionale të pakicave dhe të pjesëtarëve të tyre në sferën e identitetit nacional, kulturor, gjuhësor dhe fetar, si dhe saktësimi i statusit të

këshillave kundrejt parimit të ushtrimit të mbikqyrjes mbi punën e tyre në cilësinë e forumeve *sui generis*, me cilësinë e personit juridik dhe me autoniminë në punën e vet.

Orientimet themelore të reformës së Fondit të pakicave janë fokusuar në parandalimin e konfliktit objektivisht të mundshëm të interesave, aplikimin e dyshkallësisë gjatë vendosjes mbi projektet që financohen nga mjetet e Fondit dhe ndarja e funksionit drejtues nga funksioni afarist në vetë Fondin. Një përjasje e këtillë është e bazuar edhe në mangësitë e caktuara që janë vërejtur nga ana e institucioneve shtetërore të cilat ushtrojnë kontrollin e shpenzimit të mjeteve buxhetore (Institucioni revizor i shtetit), si dhe në të meta përkitazi me raportimin mbi aspektet e caktuara të veprimtarisë së Fondit.

Përveç fakteve të sipërpërmendura, statusi i këshillave të popujve pakicë dhe të bashkësive të tjera nacionale të pakicave si njësi të veçanta konsumatore të buxhetit, kushtëzon nevojën e ndarjes së përgjegjësisë dhe të mbikqyrjes mbi punën e tyre, duke marrë parasysh faktin se ushtrojnë funksion shoqëror të posaçëm të bazuar në rregullimin legjislativ parlamentar, në organizimin, veprimin, mënyrën e punës dhe përgjegjësinë e pavarur për veprimtari të ligjshme sikurse të gjithë personat e tjerë juridikë në përputhje me ligjin.

Nga një përcaktim i tillë kanë dalë disa zgjidhje alternative në këtë projekligj, me qëllim që edhe përmes diskutimit publik të arrihet deri te një model përkatës dhe i pranueshëm, që do të ishte në funksion të realizimit të të drejtave dhe lirive të pakicave, e njëkohësisht do t'i mbronte të gjithë pjesëmarrësit në procesin e paraqitjes së projekteve dhe të përzgjedhjes për financimin e tyre nga aspekti i objektivitetit dhe parandalimit të konfliktit të interesave.

III HARMONIZIMI ME ARRITJET JURIDIKE TË BE-së DHE ME KONVENTAT NËRKOMBËTARE TË KONFIRMUARA

Projektligji për ndyshimet dhe plotësimet e ligjit për të drejtat dhe liritë e pakicave është harmonizuar me traktatet e ratifikuara ndërkombëtare dhe me dokumentet e miratuara nën skutën e Kombeve të Bashkuara dhe të Këshillit të Europës, e sidomos :

Me Deklaratën universale mbi të drejtat e njeriut ;

Me Paktin ndërkombëtar mbi të drejtat civile dhe politike nga viti 1966 ;

Me Paktin ndërkombëtar mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore nga viti 1966;

Me Konventën ndërkombëtare për zhdukjen e të gjitha formave të diskriminimit racial nga viti 1965 ;

Me Konventën Europiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga viti 1950 dhe me protokollin numër 12 të Konventës nga viti 2000 ; dhe

Me Konventën kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale të Këshillit të Europës nga viti 1995.

Gjithashtu parimet mbi të cilat bazohet ky ligj kanë për qëllim zbatimin e parimit të jodiskriminimit të përmbajtur në nenin 21 të Kartës mbi të drejtat fundamentale të BE-së sipas të cilës ndalohet çdo diskriminim mbi bazën e gjinisë, racës, ngjyrës së lekurës, prejardhjes etnike apo sociale, karakteristikave gjenetike, gjuhës, besimit, ose bindjes politike apo çfarëdo mendimi tjetër, përkatësisë pakicës nacionale, gjendjes pasurore, lindjes, invaliditetit, moshës apo orientimit seksual.

IV SQARIMI I INSTITUTEVE THEMELORE JURIDIKE

Me nenin 1 të Ligjit mbi të drejtat dhe liritë e pakicave (“ Gazetare Zyrtare e RMZ “ nr.31/06, 51/06 dhe 38/07 dhe “ Gazetare Zyrtare e MZ “, nr. 2/11 dhe 8/11) parashikohet që në nenin 7, paragrafi 3, pas fjalës “ aktivitetet “ të vihet pikë, kurse fjalët : “ si dhe integrimin sa më të madh të romëve në jetën shoqërore dhe politike të Malit të Zi “ hiqen.

Me nenin 2 të Propozimit të ligjit shtohet neni i ri “ 7a “ me të cilin përcaktohet se shprehjet të cilat në këtë ligj përdoren për personat fizikë në gjininë mashkullore të nënkuptojnë po të njëjtat shprehje në gjininë femërore.

Me nenin 3 të Propozimit të ligjit shtohet neni i ri “ 8a “ me të cilin parashikohet që me qëllim të nxitjes së ruajtjes, zhvillimit dhe shprehjes së kulturës së popujve pakicë dhe bashkësive të tjera nacionale të pakicave në Mal të Zi, Qeveria mund të themelojë institucionin publik sipas mënyrës dhe kushteve të parashikuara me ligjin me të cilin rregullohen institucionet e kulturës.

Me nenin 4 të Propozimit të ligjit parashikohet që në nenin 11, paragrafi 2, fjalët : “ një pjesë të rëndësishme “, zëvendësohen me fjalët : “ të paktën 5 % “, kurse fjalët : “ nga regjistrimi i fundit “, zëvendësohen me fjalët : “ dy regjistrime të fundit të njëpasnjëshme “.

Me nenin 5 të Propozimit të ligjit parashikohet që në nenin 19 fjalët : “ Universiteti i Malit të Zi “, zëvendësohet me fjalët : “ institucionet universitare në Mal të Zi “, kurse fjalët : “ me aktin e Universitetit “ zëvendësohen me fjalët : “ me aktin e institucionit universitar në Mal të Zi. “.

Me nenin 6 të Propozimit të ligjit parashikohet që në nenin 28 pas paragrafit 1 të shtohet një paragraf i ri, me këtë përmbajtje :

“ Në njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilat popujt pakicë dhe bashkësitë e tjera nacionale të pakicave përbëjnë shumicën apo të paktën 5 % të popullsisë, Qeveria e Malit të Zi është e detyruar që popullatën lokale, përmes këshillave të popujve pakicë dhe të bashkësive të tjera nacionale të pakicave t’i kyçë në përgatitjen, zbatimin dhe vlerësimin e planeve dhe programeve nacionale dhe rajonale të zhvillimit, të cilat mund të kenë ndikim të drejtëpërdrejtë mbi ta, si dhe hartimin e studimeve me qëllim të vlerësimit të ndikimit të mundshëm të aktiviteteve të projektuara zhvillimore mbi popullsinë lokale për krijimin e një ambienti më të mirë për veprimtari sipërmarrëse, për zhvillim ekonomik dhe për një jetë më të mirë. “

Me nenin 7 të Propozimit të ligjit parashikohet që pas nenit 32 të shtohet një nen i ri, me këtë përmbajtje :

“ Neni 32a

Me qëllim të ruajtjes, avancimit dhe mbrojtjes së veçantive nacionale, etnike, fetare, gjuhësore dhe kulturore të pjesëtarëve të popujve pakicë dhe të bashkësive të tjera nacionale të pakicave dhe me qëllim të realizimit të të drejtave të tyre, Qeveria e Malit të Zi themelon Këshillin e popujve pakicë dhe të bashkësive të tjera nacionale të pakicave.

Qeveria e Malit të Zi përcakton përbërjen dhe kompetencën e Këshillit të popujve pakicë dhe të bashkësive të tjera nacionale të pakicave.

Përfundimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, në përbërje të Këshillit të popujve pakicë dhe të bashkësive të tjera nacionale të pakicave mund të hyjnë edhe përfaqësuesit e këshillave të popujve pakicë dhe të bashkësive të tjera nacionale të pakicave “.

Me nenin 8 të Propozimit të ligjit parashikohet që në nenin 33, në paragrafin 9, pas fjalës “neni“, vihet pikë, kurse fjalët:“ dhe anëtarët e organeve të partive politike.“hiqen.

Në paragrafin 10, fjalët : “ Organi i administratës shtetërore me kompetencë për të drejtat e pakicave “, zëvendësohen me fjalët : “ Organi i administratës shtetërore me kompetencë për të drejtat e njeriut dhe të pakicave “.

Në paragrafin 13, pas fjalës “ statuti “, vihet presja dhe shtohen fjalët : “ plani vjetor i punës “.

Në paragrafin 14, pas fjalës “ sigurohen “ shtohen fjalët : “ në shumën prej të paktën 0.10 % të mjeteve të përgjithshme buxhetore, të pakësuara për buxhetin e fondeve shtetërore dhe buxhetin kapital.”.

Me nenin 9 të Propozimit të ligjit parashikohet që në nenin 35, paragrafi 1, alinea 6, fjalët : “ Universiteti i Malit të Zi “ zëvendësohen me fjalët : “ institucionet universitare në Mal të Zi ;”.

Në nenin 10 të Propozimit të ligjit parashikohet që pas nenit 35 shtohet një nen i ri, me këtë përmbajtje :

“ Neni 35 a

Mandati i anëtarit të këshillit pushon :

- me pushimin e funksionit në bazë të të cilit është bërë anëtar i këshillit ;
- në qoftë se i kryen në mënyrë të pandërgjegjshme punët e anëtarit të këshillit ;
- në qoftë se përgjithmonë e humbet aftësinë për t’i kryer punët e anëtarit të këshillit ;
- në qoftë se është gjykuar me dënim me burgim pa kusht ose është dënuar për vepër penale e cila e bën të padenjë për të kryer punët e anëtarit të këshillit ;
- në qoftë se anëtari i këshillit nuk e justifikon mosardhjen e vet në seancën e këshillit të pakten tri herë gjatë vitit kalendarik ; dhe
- me kërkesë personale. “

Me nenin 11 të Propozimit të ligjit, pas nenit 35a shtohet një kapitull i ri, me këtë përmbajtje :

“ IIa FONDI PËR MBROJTJEN DHE REALIZIMIN E TË DREJTAVE TË PAKICAVE “

Me nenin 12 të Propozimit të ligjit parashikohet që në nenin 36, paragrafët 2 dhe 3 ndryshohen dhe kanë këtë përmbajtje :

“ Fondi ka cilësinë e personit juridik.

Me aktin mbi themelimin e Fondit rregullohen hollësisht kompetencat dhe mënyra e vendosjes së organeve të Fondit, si dhe çështjet e tjera të përcaktuara me këtë ligj”.

Me nenin 13 të Propozimit të ligjit parashikohet që neni 36a të ndryshohet dhe ka këtë përmbajtje :

“ Organet e Fondit janë këshilli drejtues dhe drejtori “.

Me nenin 14 të Propozimit të ligjit parashikohet që pas nenit 36a të shtohen 20 nene të reja : neni 36b, neni 36c, neni 36ç, neni 36d, neni 36dh, neni 36e, neni 36ë, neni 36f, neni 36g, neni 36gj, neni 36h, neni 36i , neni 36j, neni 36k, neni 36l, neni 36ll, neni 36m, neni 36n, neni 36nj, neni 36 o dhe neni 36p, me të cilët rregullohet më hollësisht funksionimi dhe puna e Fondit për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të pakicave, kompetencat e këshillit drejtues, e drejtorit dhe komisionit për vlerësimin e projekteve, mënyra dhe procedura e vlerësimit dhe e ndarjes së mjeteve për financimin e projekteve dhe paraqitja e raportit të punës.

Me nenin 15 të Propozimit të ligjit parashikohet që pas nenit 42b, të shtohen 2 nene të reja : neni 42c dhe neni 42ç, me të cilat përcaktohen afatet për harmonizimin e akteve nënligjore.

Me nenin 16 të Propozimit të ligjit parashikohet që pas nenit 44 të shtohen pesë nene të reja : neni 44a, neni 44b, neni 44c, neni 44ç dhe neni 44d, me të cilët përcaktohen afatet për marrjen e vendimit mbi themelimin e Fondit për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të pakicave, zgjedhja e këshillit drejtues, e drejtorit dhe e komisionit për vlerësimin e projekteve.

Me nenin 17 të Propozimit të ligjit parashikohet që ky ligj hyn në fuqi ditën e 8 nga data e botimit në “ Gazetën Zyrtare të Malit të Zi “.

V VLERËSIMI I MJETEVE FINANCIARE PËR ZBATIMIN E LIGJIT

Për nevoja të zbatimit të Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi të drejtat dhe liritë e pakicave nuk duhen siguruar mjete të posaçme në buxhet.

VI ARSYET PËR NXJERRJEN E LIGJIT ME PROCEDURË TË SHKURTËR

Me Planin aksional për Kapitullin negociator 19 – Mbrojtja sociale dhe punësimi dhe Planin aksional për Kapitullin negociator 23 – jurisprudenca dhe të drejtat themelore,

parashikohet miratimi i Propozimit të ligjit për ndyshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi të drejtat dhe liritë e pakicave deri në fund të tremujorit IV të vitit 2016.

Duke marrë parasysh detyrimin e respektimit të afateve nga planet aksionale të lartpërmendura, si dhe nevojat e harmonizimit të propozimit të ligjit të lartpërmendur me të drejtën europiane dhe me traktatet dhe konventat ndërkombëtare, është e domosdoshme që ky ligj të nxirret me procedurë të shkurtër.